



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 37-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 29. 09. 2020, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Naim Stullca, anëtar
8. Majlinda Sylejmani, anëtare
9. Ramadush Tasholli, anëtar
10. Arif Miftari, anëtar
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Xhyzide Rustemi, anëtare
13. Lulzim Rustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi, Hasani, anëtare
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje, prezentojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit, hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 33,34.35 dhe 36-të të Kuvendit
2. Raporti gjashtëmujor Janar-Qershor 2020 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale
3. Propozim vendim mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2021-2023.
4. Shqyrtimi-diskutimi i Raportit të auditimit të jashtëm dhe Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
5. Propozim Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit
6. Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat komunale 15Nr.434-79235 të datës 20.12.2019.
7. Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit 15Nr.670-19941 e datës 29. 05. 2020.
8. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se unë kam për t'i shtuar edhe disa pika edhe pse në rendë të ditës keni një numër të madh të pikave por nëse doni mund të hiqet Rregullorja për taksat komunale si dhe Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave.

Pikat të cilat do t'i propozoj janë:

- Propozim Vendim mbi bartjen e rezervës komunale 2020
- Raporti i performancës së komunës së Lipjanit për vitin 2019, si dhe
- Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 15Nr.400-19921 të datës 29. 05. 2020 për ndarjen e mjeteve financiare për punëtorët e komunës së Lipjanit që kanë punuar në teren gjatë pandemisë Covid-19

Lulzim Rustemi, nuk e dijë sa janë të gjata këto pika dhe nuk besoj që do të ketë nevojë që të shtyhen pasi që janë vetëm ndryshim plotësime me përjashtim të raportit i performancës të cilën nuk e dijë a do të kemi mundësi që të diskutojmë më vonë. Ne si grup e përkrahim.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se raporti i performancës është afati i fundit deri me datën 30 të këtij muaji.

Meqë diskutime tjera rreth rendit të ditës nuk pati Kryesuesi e vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 28 votat për, aprovoi rendin e ditës

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se po vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit por kam marrë vërejtje nga kolegët në KPF që mos të ju lejohet anëtarëve të Kuvendit t'i bëjnë më shumë se 2 pyetje.

Lulzim Rustemi, do të duhej që të respektohet Rregullorja e punës së Kuvendit që të ketë vetëm dy pyetje. Kam për t'i ngritur dy çështje e para ka të bëjë me DSHP-në për një gyp të kanalizimit ku do të lehtësonte kalimin e ujërave te lumi "Janjevka".

Po ashtu e kam një kërkesë të një qytetari të fshatit Lluga Misin Shala i cili e ka liru shtëpinë e vetë për shkollë por tani për shkak të kushteve jo të mira kërkon që t'i ndërtohet një shtëpi.

Shkelzen Bislimi, kam një pyetje për drejtoreshën e DKA-së të na tregoj për gjendjen në arsim se sa po respektohen masat e IKSH-së.

Rrethrotullimi në Banullë është mirë që është bërë por do të ishte mirë që rrethrotullime të tilla të kemi edhe te udhëkryqi i Smallushës si dhe te i Llugaxhisë.

Ramiz Qeriqi, unë i kam dy kërkesa për t'i ngritur por së pari është e mirë që po funksionon dhe është denu ish kryetari i komunës por duhet të keni kujdes edhe ju si po punoni.

Çështja e parë ka të bëjë rreth një kalimi për këmbësorë te hekurudha pasi që po është e vështirë të kalojnë qytetarët e asaj pjese. Çështja tjetër ka të bëjë me stadiumin e qytetit ku duhet të punohet sa më shpejt rreth atij stadiumi.

Bashkim Budakova, kam një adresim të banorëve të fshatrave Rubovc dhe Kojskë të cilët janë mirënjohës dhe falenderues për ndërtimin e shkollës por kam edhe pyetje se a e kanë menduar komuna çështjen e ujit të pijshëm për ata fëmijë të cilët e vijnë mësimin në atë shkollë.

Pyetja e dytë kur kanë filluar të vendosen shtyllat e basketbollit në mënyrë serike dhe a ka ndryshuar loja e basketbollit pyet një qytetarë.

Egzona Bytyqi, unë do ta ngris një çështje të ndijshme me karakter social ku ka shumë familje të cilat nuk kanë kulm mbi kokë dhe deshta të pyes a kanë mbetur banesa sociale në të cilat nuk janë dhënë në shfrytëzim? Do të ishte mirë që një propozim i tillë të na vinte në Kuvend. Me u formu komisioni me i caktu kriteret sa më parë që është e mundur.

Nehat Tërpeza, përgëzoj ekzekutivin për pasurimin e bibliotekës me artikuj të ri por kam një kërkesë që në bibliotekën e shkollës "Kadri Beba" në Ribar të Madh kur do të funksionalizohet pasi që është gati se në shuarje.

Argjend Tasholli, kam disa kërkesa të këshillit të fshatit Gadime; e para ka të bëjë me vendosjen e dy urave njëra te lagja Hoxha dhe tjetra te Ejupi.

Kërkesa tjetër ka të bëjë me vendosjen e hekurave mbrojtëse afër lumit te lagja Leka dhe Ejupi. Dhe kërkesa e fundit ka të bëjë me busin që i bartë nxënësit e shkollës së Gadimes i cili është i stër ngarkuar a do të ishte mirë që të jetë më i madh.

Afrim Miftari, i kam dy kërkesa e para ka të bëjë nga një grup i të rinjëve për ndriçimin e fushes së hapur në Gadime të Epërme. Dhe kërkesa e dytë vendosja e një pasqyre te rruga Gadime – Gllavicë- Marevc pasi që është dukja e pa mjeftueshme.

Alban Salihu, çështja e parë ka të bëjë rreth stadiumit kur pritet që "Ulpiana" dhe "Arbëria" me i zhvillu ndeshjet në këtë stadium. Pyetja e dytë ka të bëjë me parkingjet në rrugët kryesore që po bëhen? Është mirë drejtorati i inspektionit së bashku me policinë me reagu. Çështja e tretë ka të bëjë rreth shkollës "Emin Duraku" në Banullë a ka komuna ide apo pret ndonjë ide nga banorët e fshatit Banullë.

Albulena Kelmendi, procesi mësimor ka filluar në komunën e Lipjanit në shkollën ku punoj unë kemi filluar të punojmë me skenarin 2 duke punuar në grupe me orar 30 minuta dhe pavarësisht se sa po mundohemi ne t'i respektojmë masat në shkolla nxënësit po ju bie që nga tri orë të rrinë në kafene apo në qytet këtyre nxënësve dhe kërkoj nga DSHP-ja dhe ekzekutivi që ta ndryshoj orarin e kompanive të autobusëve në raport me procesin mësimor.

Nazmi Krasniqi, sa do të ketë afat në përgjigjjen e këtyre të cilat i shtruan parafolësit.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, e para rrjeti i kanalizimit në lagjen e Konjuhut e drejtë dhe kjo çështje duhet të zgjidhet.

Rastet e ndërtimit të shtëpive në veçanti rasti në fjalë unë e njoh edhe personalisht dhe ne duhet t'i ndjekim rrugën ligjore por edhe presim kërkesë nga ai, por fond të veçant për ndërtimin e shtëpive nuk kemi por vetëm përmes subvencioneve.

Rrethrotullimi te Llugaxhija ka qenë i kodum te Ministria.

Sa i përket hekurudhës ne kemi kërkuar për dy nënkalime por ata po vazhdojnë me projektin e tyre.

Stadiumi është interes i imi që të përfundohet sa më shpejt por është shpallë dhe ka qenë vetëm një kompani dhe ka qenë më e shtrenjtë se ajo që ne e kemi planifiku dhe lënda është në OPSH. Ndërsa stadiumi në Dobrajë është duke u punuar.

Çështja e ujit në shkollën e Rubovci më përket mua.

Çështja e banesave sociale ne kemi nda edhe më herët dhe kemi edhe disa por janë në objektet të cilat nuk kanë leje ndërtimore. Zgjerimi i urave në Gadime i disave është bërë por do të bëhet edhe për të tjerat. Ndërsa sa i përket busit ky bus nuk do të funksionoj

gjithëmonë dhe ne do të detyrohemi që ta marrim ndonjë kompani private. Për çështjen e parkingit do të diskutoj me drejtorin e inspekcionit. Për shkollën e vjetër në Banullë nëse kanë banorët ndonjë propozim apo ide ne e mirëpresim. E sa i përket çështjes së transportit për nxënësit është mirë me u rishiku orari dhe me diskutu për këtë çështje.

Elmaze Behluli, ne si DKA jemi duke respektuar të gjitha masat ku kryetari i komunës ka caktuar edhe taskforcën. Dezinfektimi nëpër shkolla është bërë dy herë, një herë në fillim të pandemisë dhe hera e dytë para fillimit të vitit shkollor. Ne ju kemi siguruar 14 mijë maska 10 dezinfektues dhe 57 termomatës në të gjitha shkollat. Po ashtu kam pasur një takim me psikologët e shkollës ku do të fillohet me një platformë.

Merita Bytyqi, është çështje individuale e secilit mjek si do të veproj me nxënësit nëse do t'i lëshoj vërtetim apo raportin mjekësor.

Ramiz Qeriqi, e pata fjalën për një nënkalim për kohën tani sa është duke u punuar pasi që po është e vështirë të kalohet nga qytetarët.

Afrim Miftari, e pata për qëllim vendosja e një pasqyre pasi që është e nevojshme për atë pjesë dhe nuk kushton aq shumë.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 33,34.35 dhe 36-të të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktet nga mbledhja e 33,34.35 dhe 36-të të Kuvendit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për

Aprovoi

Ekstraktet nga mbledhja e 33,34.35 dhe 36-të të Kuvendit

Shtesë: Ekstraktet.

I

Raporti gjashtëmuor Janar-Qershor 2020 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Ahmeti, Kryetari të Komunes, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, ne jemi ballafaqu me një sfidë e cila ka qenë lufta kundër pandemisë Covid-19. Shpresojmë që gjendja do të përmirësohet dhe do të fillon realizimi i projekteve.

Te buxheti kemi një realizim të dobët por që jep sinjale se duhet të punohet. Ajo që më ka lënë përshtypje është projekti i Janjevës dhe zona industriale në Kërçevë. Cilat punime do të bëhen. Ajo që ja vlenë me diskutu në këtë raport është pandemia e cila është thënë se është mbulu mirë por ka edhe të meta. Është mirë që janë ndihmuar disa dhe disa të tjerë janë liruar nga pagesat por na ka munguar guximi që të ndihmojmë në bujqësi dhe ndërtimtari.

Faza e parë e pandemisë ku është përfshi karantinimi i Janjevës besoj që ka qenë një veprim i ashpër i IKSHIP-së ku ka qenë një bllokadë 14 ditore pa barnatore pa postë e pa shumë qështje tjera. Ndërsa pakot ushqimore ka qenë një ndihmë e jashtëzakonshme për qytetarët. Lirimi i masave ka ndikuar që me humb fokusin te qytetarët ku një qytetarë momentin që është infektuar me Covid-19 i ka shkuar letra nga policia dhe komuna dhe nuk i ka interesuar komunës se a ka nevojë për pako ushqimore apo për pako higjienike

apo a ka nevojë dikush tjetër të bëjë testin nga ajo familje. Nuk ju ka interesu kush del për ta për nevoja ushqimore, shëndetësore ju ka dërgu vërtetimin për izolim për 14 ditë dhe ata kanë mbetë në mëshirën e kohës. Shpenzimet e qytetarëve që janë prekur me Covid-19 kanë shkuar prej 600 deri në 1000 euro. E të cilët janë anku se kërkush nuk është interesu për ta. Neve na duhet një raport detaj për Covidin.

Albulena Kelmendi, sa i përket raportit të Kryetarit unë do të flas më shumë për drejtorinë e arsimit ku vërejtjet e mija në këtë raport janë te elaborimi i mësimi online. Ku është dashtë të cekën edhe mangësitë e mësimi online edhe pse mund të ketë shkolla të cilat e kanë kryer mirë këtë punë. Nuk mendoj që janë mbajtur mësimet në të gjitha lëndët online por kjo nuk është faj i juaj por është faj i vetëdijësimi shoqëror karshi pagës të cilën e marrin. Mungesat e nxënësve janë të shumta por drejtoria e arsimit duhet më shumë me u marrë me këtë punë. Dhe me marrë sa më shumë masa për nxënësit të cilët bëjnë mungesa të pa arsyeshme.

Te shëndetësia kam një pyetje për drejtoreshën ku thuhet në raport se pediatri ka munguar në punë për tre muaj për shkak të gjendjes shëndetësore. A është kthyer ky pediatër në punë apo vazhdon ende të mos jetë në punë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, së pari e uroj kryetarin që është zgjedhur kryetar i asociacionit të komunave të Kosovës i uroj që ta kryen sa më mirë punën e tij. Kam një pyetje për shëndetësi për trotuarin në QKMF deri ku ka shkuar ai projekt.

Nazmi Krasniqi, unë do të flas më shumë rreth arsimit ku kemi nxënës shumë të pa notuar ku nga klasa 1 deri në 5 kemi 21 nxënës, ndërsa nga 6 deri në 9 më shumë nxënës. Ndërsa në shkollat e mesme mbi 60 nxënës. Ajo që është shqetësuese te nxënësit është se në gjysmëvjetorin e parë kanë nota të dobëta ndërsa në ato të dytin nota shumë të mira. Po ashtu është mirë psikologët e shkollave me dalë me një raport lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor nga nxënësit se a janë të shqetësuar për fillimin e mësimi për shkak të pandemisë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, në Janjevë kemi një projekt në bashkëpunim me komisionin evropian dhe ministrinë e kulturës në vlerë prej 12 milion euro ku do të zgjatë ky projekt 5 vite dhe do të bëhet ristaurimi i 42 shtepive sipas zgjedhjes së tyre. Po ashtu në Kërçevë pritet asfaltimi i rrugëve, ndërsa kanalizimi dhe ujërat e zeza kanë përfunduar. Pritet me përfundim edhe ujësjellësi dhe ndriçimi publik.

Sa i përket arsimit ne me mësimin online nuk mundemi me pas nivelin e kënaqshëm dhe nuk e kemi aq të lehtë këtë mënyrë të mësimi. Ka disa pajisje elektronike laptop dhe tablet të cilët kanë ardhur nga donatorë të ndryshëm për ata nxënës në ato shkolla që nuk kanë mundësi me i ble. Po ashtu do ta kenë internetin në secilën klasë.

Sa i përket pakove ushqimore nuk ka pas asnjë familje që ka guxuar me u refuzuar për me i ndihmu pavarësisht statusit të tyre. Janë nda mbi 5 mijë pako ushqimore së bashku me donatorë. Nuk ka qenë e lehtë as për shtabin emergjent, as për mjekët e as për hoxhollarët të cilët kanë qenë në teren kur ne të tjerët kemi nejt në shtëpi.

Merita Bytyqi, pediatri për shkak të gjendjes shëndetësore nuk e ka filluar ende punën por do ta fillojë në muajin tetor. Kemi shpallur konkurs për pediatër por për shkak se nuk ka pasur asnjë kandidat i cili ka aplikuar në konkurs është anuluar por konkursin së bashku me Ministrinë e shëndetësisë do ta shpallim.

Ndërsa sa i përket trotuarit në QKMF ne i kemi përfunduar të gjitha procedurat tani është te prokurimi.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati u kalua në pikën e tretë të rendit të ditës.

III

Propozim vendim mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2021-2023

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, me krahasu me kornizën afatëmesme buxhetore kemi zvogëlim mbi 400 mijë euro më pak dhe këto janë të paga dhe medijtje, ndërsa të investimet kapitale kemi rritje. Ky buxhet ka mund me qenë më i mirë dhe ka mund të punohet edhe më shumë. Është dashtë që projektet të cilat po bëhen për rrugë me u identifiku. Rregullimi i lumit “Janjevka” nuk figuron në buxhet as në vitin 2021 as 2022 e 2023. Po ashtu ndërtimi i këndit të lojërave është hiqë nga buxheti, nuk kemi as projekte të ujit të pijshëm. Mungojnë kabinetet, laboratorët dhe bibliotekat. Unë kam propozu në dëgjimet buxhetore që rruga rreth lumit Janjevka të vazhdon deri në Akllap po ashtu edhe një rrugicë në fshatin Akllap prej varrezave deri te stacioni i autobusit.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, buxheti nuk i plotëson të gjitha nevojat por jemi mundu me qu buxhetin në bazë të kërkesave të qytetarëve.

Sa i përket asaj pse i ka përfshirë disa fshatra në një projekt është për arsye që të hyjnë në një kod të veçant buxhetor.

Lumi “Janjevka” është në prioritet dhe do ta përfundojmë por kemi edhe projekte tjera siç janë edhe shtrati i lumit në Sllovi dhe Gadime.

Unë kam planifiku me i ble edhe tri auto ambulanca por nuk i kam shti në këtë buxhet pasi që pres me i fitu nga Ministria apo nga donatorët. Po ashtu këtë vit kodin e bashkëpunimit e kemi më të rritur pasi që kemi orëmatësit për ujë me CDI-n si dhe fasadimi i ndërtesave të qytetit ku përfshihen tri objekte. Sa i përket rrugicave dy Gadimet janë përfunduar dhe pritet që të vazhdohet edhe me Sllovinë dhe fshatrat tjera. Jemi në diskutim për grumbullimin e mbeturinave bashk me Drenasin dhe Fushë Kosovën projekt ky nga Ministria. Kabinetet janë të përfshira te mallërat dhe shërbimet. Po ashtu aty janë të përfshira edhe lumenjtë si dhe mirëmbajtja e varrezave.

Shkelzen Bislimi, viti 2021 do të jetë vit zgjedhor qysh e dinë të gjithë por edhe planifikimi i buxhetit po shkon në asfalt dhe rrugica, por komuna duhet të shkoj me një start tjetër buxhetin ta qoj në arsim dhe shëndetësi. Planifikimi i buxhetit është larg nevojave dhe ne si grup i VV-së do të votojmë kundër këtij propozim vendimi.

Lumturije Bytyqi-Hasani, nuk e dijë sa ka mundësi me u planifiku buxhet për pagat jubilarë edhe pse jemi shumë vonë por unë një propozim të tillë e kam dhënë edhe në KPF dhe do të ishte mirë që këto paga për arsim dhe shëndetësi t'i planifikojnë e jo të lihen palët me shku në gjykata.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, Shkelzeni nuk dha asnjë ide se duhet të shtohet ndonjë projekt apo të hiqet ndonjë projekt tjetër. Pagat jubilarë e drejtë e ngritur por ne kryetarët e komunave kemi ngritur disa herë këtë çështje arsya është se komunat nuk janë palë nënshkruese por janë ministritë përkatëse. Dhe ne si komuna po dëmtohem ku sipas një kërkesë të dorëzuar në Gjykatë Kushtetuese nga komuna e Kaçanikut përgjegjëse për pagat jubilarë janë Ministritë.

Ukë Kryeziu, ne sot jemi duke diskutu një rën prej vendimeve më të rëndësishme e që është buxheti. Pjesa e vazhdimit të lumit në Sllovi ka ndryshu pamjen e këtij vendi dhe duhet të vazhdohet edhe më tutje. Ndërsa sa i përket rrugicave në Sllovi nuk ka qenë edhe mirë por tani është e mirë që po përfshihen. Te shëndetësia, te investimet kapitale, unë e kam ngrit disa herë blerjen e një aparati të rengenit për QKMF i cili është diku i viteve të 70-ta dhe është e nevojshme që ai aparat të blehet. Po ashtu AMF në Sllovi duhet të kthehet në QKMF dhe të ketë 12 orë shërbime pasi që Sllovia numron afër 4 mijë banorë dhe i plotëson kushtet. Në shëndetësi duhet të investohet edhe në blerjen e çarshafëve po ashtu edhe stafi shëndetësorë duhet të ketë uniformë të njejtë për të gjithë. Për fund deri kurë ka shku çështja për rrugën Sllovi-Lipjan?

Lumturije Bytyqi-Hasani, Ligji i pagave nuk ka hy në fuqi dhe ato mjete nuk janë leju për destinime të tilla për pagat jubilarë por ju kryetarët e komunave duhet të bëni më shumë presion në Ministri që ato paga me u përdorë për destinim të tillë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, ne nuk po kemi mekanizma tjerë përveq shkresave. Ndërsa sa i përket rrugës Sllovi-Lipjan ne kemi mbet keq pasi që ajo kompani

është shu dhe ne nuk kemi mundësi as si ta paguajmë pasi që nuk kanë as konto dhe askush prej tyre nuk vjen as të shkëpus kontratën.

Afrim Miftari, kërkoj një sqarim të investimet kapitale për vitin 2021, 2022 dhe 2023 që ka një dallim. Ne po kritikojmë për buxhet të asfaltit po kryesisht kërkesat dhe nevojat e qytetarëve po janë për asfalt dhe trotuar. Dhe ne duhet t'i gëzohemi çdo investimi i cili po bëhet. Është e mirë që është parapa ndërtimi i një shkolle në Gadime. Por kam një kërkesë që rrugicat të cilat po asfaltohen të specifikohen.

Arben Salihu, kam për t'i ngritur disa çështje të çështja e shpronësimit a do të na mjaftojnë këto mjete. E dyta ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan një lajm i mirë që do të ndërtohet por a është caktuar lokacioni apo do të ndërtohet në pjesën ku gjendet shkolla fillore "Vllëzërit Frashëri".

Argjend Tasholli, ndërtimi i shkollës në Gadime një e mirë që po bëhet por qytetart po pyesin pse nuk po ndërtohen dy shkolla siq ka premtuar kryetari. Po ashtu kam një kërkesë të shoqatës të veteranëve për ndërtimin e lapidarit të Tahir Sinanit. Të pakten në buxhetin e ardhshëm.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, rrugicat nuk po specifikohen për arsye sepse nuk kanë emër. Por unë kërkoj nga ana e juaj delegat pavarësisht subjekteve politike të na ndihmoni se cilat rrugë duhet të shtrohen. Ndërsa për lokacionin e shkolles në Gadime unë kam biseduar me Naser Kaçaren dhe Skender Ademin dhe ideja ka qenë që shkolla të ndërtohet në vendin ku ka qenë shkolla e vjetër. Shkolla fillore në Lipjan do ndërtohet te shkolla ku gjindet tani mbrapa sajë. Mjetet për shpronësim nuk e dijmë se sa do të shkojnë. Në Gadime vetëm le të gjindet prona unë jam i gatshëm me e ndërtu shkollën. Shkolla fillore në Rufe dhe në Topliqan do të renovohen, ndërsa në Ribar të Madh duhet të ndërtohet e re.

Bashkim Budakova, sa i përket propozim vendimit unë kam vërejtjet e mia pasi që gjatë dëgjimeve buxhetore i cili është mbajtur me datën 11.06.2020 në Rubovc ka pas shumë kërkesa të banorëve siq janë nga Rubovci i Vogël ka qenë kërkesë për zgjedhjen e çështjes së kanalizimit. Ndërsa kërkesa të Rubovcit të Madh ishte zgjidhja e problemit të varrezave, ndërtimi i urave të lumi si dhe asfaltimi i rrugicave së bashku me trotuarët dhe ndriçim publik. Nuk e dijmë pse kërkesat tona nuk janë marrë parasysh por shpresojmë që me ridestininim të mjeteve apo me rishikim të merren parasysh.

Nazmi Krasniqi, unë mendoj se fajin për pagat jubilarë e kanë edhe komunat edhe ministrinë por duhet të zgjedhet kjo çështje sa më shpejt. Çështja e ndërtimit të shkollës në Gadime që është ndërtu nuk kemi pasur zgjidhje tjetër për pronë dhe e kemi ndërtu në atë pjesë dhe nuk mendoj që është bërë keq në atë pjesë në atë shkollë.

Lulzim Rrustemi, duhet që të ketë zgjidhje edhe për çerdhen në Shalë pasi që me sa e pashë unë nuk është në buxhet.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, ndërtimi i shkollës në Gadime nuk thash që është bërë gabim por me ndërtimin e asaj shkolle nuk është bërë zgjidhje dhe zgjidhja më e mirë do të ishte në mes të fshatit aty dikun kah shpella. Ndërsa çerdhja në Shalë do të bëhet ku do të kaloj te zyra e vendit, ndërsa zyrën e vendit do ta qojmë në një vend tjetër. Në Rubovc është duke u punuar me kanalizim po ashtu edhe në Pojatë, po ashtu edhe asfaltimi i disa rrugicave e sa i përket çështjes së varrezave ajo është në proces gjyqësorë.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 23 vota për, 3 kundër dhe 1 apstenim aprovoi këtë:

Pastaj Kryesuesi dha pauzë nga ora 13¹⁵ deri në ora 14³⁰

VENDIM
MBI APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITET 2021-2023

Neni 1.

Me këtë Vendim aprohet Buxheti për vitet 2021-2023 për Komunën e Lipjanit.

Neni 2.

Buxheti për vitet 2021-2023 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2021	VITI 2022	VITI 2023
Grant i Përgjithshëm	5,723,937.00	6,012,093.00	6,294,575.00
Grant Specifik i Arsimit	6,916,540.00	7,563,566.00	7,595,510.00
Grant Specifik i Shëndetësisë	1,996,362.00	3,087,960.00	3,103,400.00
Të hyrat vetanake	1,907,316.00	2,161,247.00	2,260,817.00
Financimi Shërbimet Rezedenciale	175,000.00	175,000.00	175,000.00
TOTALI	16,719,155.00	18,999,866.00	19,429,302.00

Neni 3.

Mjetet nga neni 2.i këtij Vendimi do shpërdahen në kategorit ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	VITI 2021	VITI 2022	VITI 2023
Paga e Mëditje	9,574,000.00	9,600,424.00	9,648,426.00
Mallra dhe Shërbime	1,700,000.00	1,774,799.00	1,742,025.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	280,000.00	284,402.00	296,252.00
Subvencione dhe Transfere	500,000.00	532,829.00	564,172.00
Investime Kapitale	4,665,155.00	6,807,412.00	7,178,427.00
TOTALI	16,719,155.00	18,999,866.00	19,429,302.00

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi pas publikimit në Web faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve.

Neni 6.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

IV

Shqyrtimi-diskutimi i Raporti i auditimit të jashtëm dhe Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nehat Terpeza,ne si grup i LDK-së e kemi shqyrtu dhe e vlersojm lartë punën që është bërë ne vitin 2019 dhe e inkurajojm te vazhdoi me këtë fakt. Kamë një pyetje si ndihet Kryetari para kryetareve të tjerë kur e merr këtë çmim.

Lulzim Rrustemi,një raport që duhet me u përshëndetur por ka shumë telashe e të meta të cilat duhet të përmirësohen.Te menaxhimi financiar i kontrollit ekzistojnë disa mundësi për të përmirësuar.Te planifikimi i buxhetit është rritur bixheti për 1 milion euro.Ndërsa te investimet kapitale shifer jo e mirë.Te pagat jubilarë klasifikim jo i mirë i shpenzimeve.Janë punësuar mbi 70 punëtorë dhe 90 % nga vija partiakë,ndërsa ata të cilët nuk janë të kësaj partie nuk mund të punësohen.Te mallrat dhe shërbimet duhet ti ndjekim të gjitha procedurat.

Latif Ramadani,vlerësimi i auditorit është vlerësimi më i lartë i bërë që është opinion i pa modifikuar dhe auditori është i pavarur nuk ta falë anjë shkelje të cilën ti e bënë.

Alban Salihu,është bërë traditë që zyra e auditorit të shfaqë për çdo vit parregullsitë e komunës së Lipjanit.Ku lënë hapësirë për keqmenaxhim e kurdisje.Disa komuna i kanë planifikuar pagat jubilarë ndërsa te komuna jonë po i mer thesari.Po ashtu komuna po vazhdon me vonesën e projekteve siç është trotuari me ndriçim publik në Konjuh përreth lumit Janjevka.

Nehat Terpeza,raporti i auditorit është një raport që komunën tonë e ka vlerësuar lartë si opinion i pa modifikuar dhe këtë vlerësim e ka marr komuna jonë qe dy vite.

Albulena Kelmendi,raport i pa modifikuar është momentin kur paraqiten raportet vjetore të cilat nuk kanë nevojë me u prekë dhe unë nuk e di se cila komunë ka raport të modifikuar.

Latif Ramadani,unë para juve e lexova raportin e auditorit dhe këtë raport nuk e kemi shkruar ne.

Safet Krasniqi,kemi katër lloje të opinionit dhe nuk ka nevojë me e mohuar pasi që është duke u bërë përmirësime ku së pari kanë qenë 15 rekomandime tani 9 dhe ka rënë në 6 rekomandime.Faza e parë e raportit është 30 Shtator ndërsa faza e dytë 31 Mars.

Alban Salihu,njëra prej rekomandimeve ka qenë se është bërë vonesa nga kompania por nuk është bërë ndëshkimi për atë kompani.

Latif Ramadani,unë e thash edhe më herët se nuk ka raport më të mirë se sa opinion i pa modifikuar me të cilin jemi vlerësuar ne.

Argjend Tasholli,sipas raportit gjendja është e mirë por ne si grup i PDK-së mendojmë se gjendja është jo e mirë pasi që vazhdon avazi i vjetër me borgj të mbetura e të pa paguara.Po ashtu selektim i realizimit të tenderëve ,selektim në subvencione,mungesë e planit vjetor për OJQ etj.

Latif Ramadani,mjetet të cilat i kemi pasur i kemi paguar dhe pagat jubilarë nuk kemi mundur me i palnifikuar sepse nuk kemi pasur kod të veçantë.

Nazmi Krasniqi,shpeshherë edhe nxënësve iu ipet nota 5 e pa merituar.

Arben Salihu,është e pamundur që në 1500 punëtorë mos me u gjetë një gabim dhe ne jemi ata që duhet të ngrisim zërin për gabimet që bëhen.

V

Propozim Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Rasim Hasani, drejtor i DSHP-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi,ne si grup e përkrahim këtë propozim rregullore por te neni 13 është shkelje e të drejtave të njeriut,është mirë edhe një herë me e shikuar këtë qështje.

Deponia te "Sitnica" në cilën e kemi pastruar çfarë statusi ka tani.Dhe te fshati Bregu i Zi është marr vendim nga kuvendi për një vend për mbeturina inerte çka ka ndodhur me atë vendim.

Afrim Miftari,kam një pyetje të cilën e kam bërë edhe në KPF,se a janë trajtuar mbeturinat inerte me këtë rregullore,është mirë të përfshihet me një nen edhe kjo çështje.

Rasim Hasani,sa i përket nenit 13 ne jemi konsultuar me zyrën ligjore dhe ata na kanë thënë që nuk e kemi gjetur dikun që e ndalon.Deponia te „Sitnica,, është mbyllur,ndërsa , sa i përket asaj te Bregu i Zi nuk po funksionon ajo deponi.

Daut Azemi,ne jemi munduar me modifikuar këtë Rregullore dhe propozimin të cilin e dha Drejtori,duhet të hiqet neni 13 dhe duhet të riformulohet.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim rregullore dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 22 votat për 3 astenime aprovoi këtë:

VI

Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat komunale 15Nr.434-79235 të dates 20.12.2019.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Rasim Hasani, drejtor i DSHP-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi,këto taksa janë risi për qytetarët por pajtohna që të kalojë kjo Rregullore edhe pse shumica e bizneseve janë të lidhura direkt me trotuarin dhe mos është mirë që të hiqet kjo taksë.

Afrim Miftari,unë mendoj që duhet të jetë ky nen pasi që edhe qytetarët duhet të kenë konsideratë që të kryejnë punën më shpejtë,pasi që këtu thuhet pas një ore.

Ramiz Qeriqi,mua po më intereson për një biznes afër komunës së re i cili i ka marr dy parkingje se a paguan ai për ato parkingje.

Rasim Hasani,ne kemi menduar që me këtë Rregullore me e liruar trotuarin dhe me krijuar mekanizëm që kjo të lehtësonte punën,por prap ju anëtarët e kuvendit vendosni.

Naim Stullca,unë mendoj që kjo Rregullore është e mirë por sa i përket trotuarëve kjo do ju shkaktoj probleme pasi që janë të lidhura direkt me trotuar.

Ramiz Qeriqi,është pikërisht furra Drini e cila e ka bllokuar rrugën.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregullore dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 23 votat për 3 apstenime aprovoi këtë:

VII

Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit 15Nr.670-19941 e dates 29. 05. 2020.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Elmaze Behluli, drejtoreshë e DKA-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nehat Tërpeza,ne si grup i LDK-së e kemi shqyrtuar këtë propozim Rregullore dhe e përkrahim.

Albulena Kelmendi,unë e kam dhënë qëndrimin tim edhe në KPF dhe kam qenë kundër por në emër të grupit e përkrahim këtë propozim Rregullore.

Lulzim Rustemi,kjo Rregullore ka qenë e mirë dhe nuk është dasht që kolegjet private me u përfshi pasi që ata studimet i paguajnë vetë.Ne nuk jemi kundër por Rregullorja e deri tanishme është dashur të shkoj për këtë vit.

Nehat Tërpeza,para zyrës së akreditimit të gjitha janë të barabarta dhe nuk kanë dallime.

Nazmi Krasniqi,një Rregullore që duhet përshëndetur,por ne duhet të bëjmë një analizë për të cilën studentët kanë nevojë më shumë,dhe ato kuadro që kemi më shumë nevojë ato të subvencionohen.

Afrim Miftari,ne e përkrahim këtë propozim Rregullore dhe është e mirë që do ju ipet mundësi që të konkurojnë edhe atyre studentëve të UP-së si dhe të kolegjeve private.

Albulena Kelmendi,të gjithë qytetarët janë të barabartë për atë edhe ne si grup votuam pro kësaj Rregulloreje,por nuk pajtohna që në kolegje private regjistrohen ata student të cilët i kanë kushtet e mira por regjistrohen edhe studentet të cilët nuk kanë mundur të regjistrohen në UP.

Lulzim Rustemi,kam një sygjërim që të ftojme Drejtorin e UBT-së Edmond Hajrizin që të bisedojmë për studentet e Lipjanit lidhur me pagesën 50 % më lirë.

Daut Azemi,po e ndjej si obligim që me e ftuar për takim Drejtorin e UBT-së dhe me i shprehur shqetësimet tona si kuvend.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 21 votat për dhe 2 apstenime aprovoi këtë:

VIII

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, drejtor i së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendim.

Daut Azemi,tha se në vend të Ilir Tashollit do të jet Rasim Hasani,ndërsa në vend të Anila Reqica Llugini do të jetë Fatime Krasniqi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 22 votat për dhe 2 apstenime aprovoi këtë:

IX

Propozim Vendim mbi bartjen e rezervës komunale 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, drejtorit Latif Ramadani, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Meqë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 21 votat për aprovoi këtë:

X

Raporti i performancës së komunës së Lipjanit për vitin 2019

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shemsi Azemit Shef i Tatimit në Pronë, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendim.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Albulena Kelmendi,neve na mbetet me lexu kete raport me i adresu pyetjet në seancen e ardhshme,ku te barazia gjinore, te punësimi e shumë fushati tjera ku përafqëesimi i grave dhe vajzave në këshillat e fshatrave ke zero ku është dashtë me pas fushata senzibilizuese.Ne jemi te gatshëm që të ju ndihmojmë për këto fushtata.

Shemsi Azemi,vitin e kaluar janë futur edhe disa tregues të ri ku është mirë në të ardhmën emërtimet e rrugëve të kenë edhe emra të gjinisë femrore.

XI

Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 15Nr.400-19921 të dates 29. 05. 2020 për ndarjen e mjeteve financiare për punëtorët e komunës së Lipjanit që kanë punuar në teren gjatë pandemisë Covid-19

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Alban Salihu,ne edhe atëherë kemi votu kundër jo për shkak se ku janë marrë mjetet po për shkak se punët vullnetare i kemi obligim,kemi votu kundër dhe prap kundër do të votojmë edhe këtë herë.

Daut Azemi,sa për spjegim këtu është stafi stafi i shërbyesve civilë të komunës,e drejtorët që tha kryetari ka ngarku,e ka shkarku qe e tha më herët kryetari njihet si punë vullnetare.Kjo është për punëtorët e komunës të cilët e kanë rezikuar edhe vetën edhe familjet e tyre për shkak të situatës me pandeminë.

Ganimete Qeriqi,kur është ngritë kjo qështje kam votuar për por tash do të votoj kundër,për shkak se në QKMF ka pas diskriminim ku disa punëtorë kanë punu gjatë pandemisë por nuk janë pagu.

Daut Azemi, na e kemi qu në minsitri më herët vendimin për më përfshi edhe të tjerë por ata kanë mbet peng e vendimit të qeverisë.Na po flasim për punëtorët e komunës te cilët edhe gjatë karantinimit në Janjvë këta punëtorë kanë bërë punë të jashtëzakonshme.

Nehat Tërpeza,këtu po bëhet fjalë për shërbyesit civilë ,jo për stafin e ngushtë të kryetarit të cilët në kohën e pandemisë kanë rrezikuar shëndetin e tyre edhe të familjes së tyre.Dhe është shumë e padrejtë nëse ne nuk e bëjmë një plotësim ndryshim të atij vendimi.

Latif Ramadani,këta njerëz janë kanë super hero për atë kohë,nuk u kanë aq e lehtë me shpërnda ndihma në atë kohë,ku edhe unë vet kam qenë pjesë e këtij shtabi.

Albulena Kelmedni,heroj dhe super heroj kanë qenë edhe punëtorët e super marketeve të cilët kanë punuar me pagë minimale në atë kohë.Këta punëtorë që kanë dalë në teren nuk janë kanë te vetimit por prap bravo per ta për solidaritetin e treguar.

Këta punëtorë në kohë krize nuk ju ka ndalë paga ,nuk kanë kry punë në komunë po kanë kry këtë punë, ka kategori tjera që nuk janë përfshi në këtë pagesë.

Daut Azemi,njëjtë sikur ju që e keni kry punën prej shtëpisë online e keni marrë rrogën,këta kanë ardh në punë çdo ditë.

Latif Ramadani,kategoritë tjera i kanë marrë me vendim të qeverisë,e këta punëtorë në atë kohë kanë qenë super hero të cilët kanë ngarku e shkarku.

Nazmi Krasniqi, pse deri tani nuk është bërë kjo pagesë,ne jemi për me votu këtë propozim vendim.

Afrim Miftari, ne vendimin e kaluar e kemi votu edhe më herët, do ta votojmë prap këtë vendim, por u kanë mirë me kanë lista e personave që do të përfitojnë.

Daut Azemi, ne po flasim vetëm për me ndërru kategorinë, lista ajo që ka qenë ma herët është e njëjta.

Meqë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 16 votat për 2 kunder 1 apsetnim aprovoi këtë:

Shtesë; Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 1,¹⁵

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi